

TERMA REFERENCE

Ekspert për hartimin dhe konceptimin e skripteve për video, infografe, deklarata publike si dhe materiale të tjera vizibiliteti në funksion të projektit

Pozicioni/shërbim	Ekspert për skripte (video, infografe, deklarata)
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi – ekspert
Periudha e kontratës	Janar – Shkurt 2024
Ditët e punës	6 ditë pune

Informacion i përgjithshëm për Projektin

Projekti ka për qëllim zhvillimin më të mirë të zgjedhjeve parlamentare 2021 me zbatim të plotë të kornizës ligjore dhe institucionale në lidhje me ndryshimet e Kodit Zgjedhor 2020.

Projekti synon:

- Analizë ekspertize të kuadrit ligjor që rregullon krijimin dhe punën e strukturave të KQZ , identifikimin e akteve nënligjore që do të dalin dhe afatet e zbatimit të tyre dhe adresimin e përgjegjësive, ngritjen e një sistemi “alarmi” për të kujtuar KQZ-në mbi rreziqet e tejkalimit të afateve të zbatimit të akteve.
- Monitorim të gjykimeve të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve në lidhje me ankesat e subjekteve zgjedhore dhe monitorim të strukturës gjyqësore pranë KQZ dhe analizën e vendimeve të KAS dhe të kolegjit zgjedhor.
- Monitorim i zbatimit të kuotës gjinore në të gjitha fazat e procesit zgjedhor për të parë si zbatohen kërkesat ligjore për respektimin e kuotës gjinore dhe sanksionet e vendosura nga KQZ.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, Instituti i Studimeve Politike kërkon një ekspert për hartimin dhe konceptimin e skripteve për video, infografe, deklaratave publike si dhe materiale të tjera vizibiliteti në funksion të projektit.

Rolet dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushin kandidatet:

- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive për prodhimin e produkteve multimediale (video, infografe dhe deklaratave) që përputhet me qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të organizatës;
- Analizimi i qëllimeve dhe objektivave të projektit në funksion të prodhimit të materialeve për vizibilitetin e projektit;
- Skriptimi i videove , infografeve, deklaratave dhe produkteve të tjera të vizibilitetit për platformat e rrjeteve sociale të ISP;
- Redaktimi i përmbajtjes kur është materiali bazë vjen nga ekspertët ose stafi i ISP;
- Koordinimi me drejtuesit e projektit, ekspertët ose stafin e ISP , për materialin e brendshëm;
- Bashkëpunimi me subjektet në prodhimin e materialeve të vizibilitetit (videove, infografeve) duke dhënë idetë e tij dhe duke ofruar mbështetje në prodhimin efektiv multimedial, për t'i bërë ato më tërheqëse për audiencën.

Eksperti duhet gjithashtu:

- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojtë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Profili i ekspertit:

- Diplomuar në nivelin Master Profesional/Shkencor në fushën e Gazetarisë, Komunikimit, Gjuhësisë;
- Eksperiencë në fushën përkatëse;
- Aftësi individuale dhe profesionale;
- Të jetë i/e pavarur dhe i/e paanshëm/e;
- Të gëzojë integritet profesional e morale;

- Të ketë aftësi shumë të mira analitike dhe mendimi kritik;
- Të respektojë detyrat dhe afatet e vendosura nga ekipi zbatues i projektit.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar;
2. Ofertë Financiare e nënshkruar në GBP.

Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 600 GBP (gjashtëqind) bruto. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas paraqitjes së materialeve të realizuara nga eksperti për punën e kryer.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 19/01/2024, ora 12:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit: contactaips@gmail.com ,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër *“ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike –ekspert për skripte (video, infografe, deklaratë). Të mos hapet përpara datës së tenderit”*, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P. 89, K.3, Ap. 16, Tiranë;
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër *“ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike ekspert për skripte (video, infografe, deklaratë). Të mos hapet përpara datës së tenderit.”*, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P. 89, K.3, Ap. 16, Tiranë.

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike